



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 247/17 prot

Datë 20.04.2022

V E N D I M

Nr. 360/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.04.2022, shqyrtoi çështjen me:

- Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Kleidi” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur, e thjeshtuar*” me Nr. REF-17375-01-19-2022, me objekt “*Blerje karburanti për nevojat e Bashkisë për vitin 2022*” me fond limit 7,280,718.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 01.02.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dropull.
- Ankimues:** “Kleidi” SHPK
Dropull i Sipërm, Vrisera, Rr.nacionale Gjirokastër, Kakavijë
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Dropull
Jorgucat, Gjirokastër
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Ligji Nr. 10279 datë 20.5.2010 “*Për kundërvajtjet administrative*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.

500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Ankimuesi ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.01.2022, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-17375-01-19-2022, me objekt “Blerje karburanti për nevojat e Bashkisë për vitin 2022” me fond limit 7,280,718.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 01.02.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dropull.

II.2 Në datën 02.02.2022 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi vlerësimin e ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar.

“Kleidi” SHPK me marzh fitimi 8.8 lekë/litërskualifikuar

“Anel & Co” SHPK me marzh fitimi 15 lekë/litër kualifikuar

Operatori ekonomik “Kleidi” SHPK rezulton i skualifikuar me argumentet si vijon:

Ne mbeshtetje te nenit 26 pika 7 te Vkm nr.285 dt.19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik:Autoriteti kontraktor ka te drejte te kryeje verifikimet e nevojshme mbi vertetesine e informacionit te deklaruar nga operatori ekonomik...Nga verifikimi ne vend nga komisioni ne dt.02.02.2022 ne oren 12.13 ne karburantin e shoqerise “KLEIDI” ne Vrisera u

verifikua se ne karburant nuk ka sistem elektronik per kryerjen e sherbimit me karta elektronike.”

II.3. Në datën 08.02.2022 është publikuar njoftimi i fituesit në SPE.

II.4. Në datën 09.02.2022 operatori ekonomik “Kleidi” SHPK ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, lidhur me skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin e publikimit lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Kleidi” SHPK.

II.6. Nëpërmjet shkresës me nr. 301 prot., datë 17.02.2022, protokolluar me tonën me nr. 247/3 prot., datë 17.02.2022 me objekt “*Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të ankesës*”, drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik dhe për dijeni shoqërisë “Kleidi” SHPK, është depozituar nga autoriteti kontraktor në KPP, vendimi mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Kleidi” SHPK dhe ka vendosur mospranimin e ankesës.

II.8. Për shkak të specifikës së kësaj procedure prokurimi, për sqarimin e fakteve dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, të papranuara nga autoriteti kontraktor, në datën 03.03.2022, nëpërmjet shkresës nr. 247/6 prot., me objekt: “*Kërkesë për informacion*”, Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke i kërkuar informacion *nëse regjistohen, kolaudohen sistemet elektronike për kryerjen e shërbimit me karburant me karta elektronike në pikat e karburantit dhe nëse përgjigja është pozitive, cila është kompania private apo institucioni shtetëror i cili është ngarkuar ligjërisht për digitalizimin e sistemeve në pikat e karburantit në Republikën e Shqipërisë*. Në mungesë të përgjigjes nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 247/7 prot., datë 17.03.2022 me objekt: “*Rikërkesë për informacion*”, me qëllim gjykimin e drejtë të ankesës së paraqitur, Komisioni i Prokurimit Publik ripërsëriti kërkesën për sqarim drejtuar këtij institucioni.

II.9. Me shkresën nr. 247/5 prot., datë 03.03.2022 me objekt: “*Vënie në dijeni*”, drejtuar Bashkisë Dropull dhe për dijeni operatorit ekonomik “Kleidi” SHPK dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar nenit 115, pika 5 e ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku përcaktohet se: “*5. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës Komisioni i Prokurimit Publik ka nevojë të kërkojë ekspertizë nga palë të treta ose të*

kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 4 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Afati për marrjen e vendimit nuk duhet të tejkalojë 30 ditë. Në çdo rast Komisioni i Prokurimit Publik ka detyrimin të vërë në dijeni palët”, u bëri të ditur të gjitha palëve, se për shkaqe të nevojshme për verifikim, në përputhje me dispozitën e sipërcituar, nuk është e mundur dalja me një vendim përfundimtar brenda afatit të parashikuar në ligjin e prokurimit publik.

II.10. Me shkresën nr. 247/9 prot., datë 30.03.2022 Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi Bashkisë Dropull paraqitjen e provave që vërtetojnë datën e dorëzimit të formularit të ankesës së operatorit ekonomik “Kleidi” SHPK, pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e mësipërme të prokurimit. Njëkohësisht me shkresën nr.247/10 prot., datë 30.03.2022 Komisioni i Prokurimit Publik, gjykoi të nevojshme të kërkojë nga ana e operatorit ekonomik ankimes “Kleidi” SHPK, paraqitjen e provave që vërtetojnë datën e dorëzimit të formularit të ankesës pranë autoritetit kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.11. Me shkresën nr. 301/2 prot., datë 30.03.2022 me objekt: “Kthim-përgjigje”, dërguar nëpërmjet postës elektronike zyrtare të KPP-së, autoriteti kontraktor informon Komisionin e Prokurimit Publik si vijon:

“Në përgjigje të shkresës tuaj me nr. 247/9 prot., datë 30.03.2022, bazuar në vendimin nr.1/2022 të autoritetit kontraktor, me nr.301 prot., datë 15.02.2022, e kemi theksuar te rrethanat e çështjes, pika II.6 “Në datën 09.02.2022 operatori ekonomik “Kleidi” SHPK ka paraqitur ankesë nëpërmjet sistemit të APP-së dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik me objekt kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit të tij në procedurën e prokurimit të objekt-ankimit.” Ndërsa pranë bashkisë tonë nuk është dorëzuar formulari i ankesës së operatorit ekonomik “Kleidi” SHPK në rrugë shkresore.”

II.12. Në datën 04.04.2022 dhe 05.04.2022 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 247/11 prot., dhe 247/12 shkresa e operatorit ekonomik “Kleidi” SHPK, datë 02.04.2022, drejtuar këtij komisioni me përmbajtjen si vijon:

“Subjekti “Kleidi” SHPK [...], në përgjigje të shkresës me nr. 247/10 prot., të datës 30.03.2022, marrë në dorëzim nga posta në datën 02.04.2022, sipas kërkesës, ju vë në dispozicion provat që vërtetojnë datën e dorëzimit të formularit të ankesës pranë autoritetit kontraktor në datën 09.02.2022 për procedurën e prokurimit [...] blerje kaburanti për nevojat e Bashkisë për vitin 2022. Bashkëngjitur gjeni mandatin e postës nisur në datën 09.02.2022 për autoritetin kontraktor; dokumentin e lajmërim-marrjes, nisur në datën 09.02.2022 nga subjekti “Kleidi” SHPK, firmosur nga institucioni marrës Bashkia Dropull; vendimin e Bashkisë Dropull; zarfin e postës për marrjen e kërkesës për informacion nga KPP.” Bashkëngjitur kësaj shkrese është dëftesa e pranimin të objekteve postare nga Zyra Postare, Tiranë me datë 09.02.2022, me kod LM RR258904481AA, me dërgues “Klaidi” SHPK dhe marrës Bashkia Dropull, dokumentin e lajmërim-marrjes, vendimin e Bashkisë Dropull; zarfin e postës për marrjen e kërkesës për informacion nga KPP.

II.13. Me shkresën nr. 247/13 prot., datë 05.04.2022, Komisioni i Prokurimit Publik, i kërkoi Bashkisë Dropull informacionin si vijon: “Me shkresën nr. 301 prot., datë 15.02.2022,

protokolluar me tonën nr.247/3 prot., datë 17.02.2022 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Kleidi” SHPK. Sipas kësaj shkrese rezulton se ankimuesi ka paraqitur ankesë në AK nëpërmjet sistemit të APP-së. Me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 115 të LPP-së, Komisioni i Prokurimit Publik gjykoj të nevojshëm ti kërkojë AK-së paraqitjen e provave që vërtetojnë datën e dorëzimit të formularit të ankesës së operatorit ekonomik “Kleidi” SHPK pranë autoritetit tuaj kontraktor. Njëkohësisht Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoj edhe shoqërisë “Kleidi” SHPK paraqitjen e provave që vërtetojnë datën e dorëzimit të formularit të ankesës pranë autoritetit kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Me shkresën nr. 301/2 prot., datë 30.03.2022, me objekt: “Kthim përgjigje”, dërguar në adresën zyrtare elektronike të Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor konfirmon si më poshtë vijon: “Në përgjigje të shkresës suaj me nr. 247/9 prot., datë 30.03.2022, bazuar në Vendimin nr. 1/2022 të autoritetit kontraktor me nr. 301 prot., datë 15.02.2022, e kemi theksuar në rrethanat e çështjes, pika II.6 “Në datën 09.02.2022 operatori ekonomik “Kleidi” SHPK ka paraqitur ankesë nëpërmjet sistemit të APP-së dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me objekt kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit të tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.” Ndërsa pranë bashkisë sonë nuk është dorëzuar formulari i ankesës së operatorit ekonomik “Kleidi” SHPK në rrugë shkresore.”

Në datën 04.04.2022, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit me nr. 247/11, përgjigja e shoqërisë “Kleidi” SHPK, drejtuar KPP-së, bashkëngjitur provat që vërtetojnë datën e dorëzimit të formularit të ankesës pranë autoritetit kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit. Për sa më sipër, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 115 të LPP-së, Komisioni i Prokurimit Publik e gjykon të nevojshme të kërkojë informacion, nëse është dorëzuar materiali i pretenduar nga ankimuesi dhe i dokumentuar me provat përkatëse, bashkëngjitur kësaj shkrese”.

II.14. Për shkak të specifikës së kësaj procedure prokurimi, për sqarimin e fakteve dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, të papranuara nga autoriteti kontraktor në datën 05.04.2022, nëpërmjet shkresës nr. 247/14 prot., me objekt: “Kërkesë për informacion” Komisioni i Prokurimit Publik, iu drejtua Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial, si institucion kompetent, për një sqarim nëse ka kompani private apo institucion shtetëror i cili është ngarkuar ligjërisht për certifikimin/kalibrimin/etj. e sistemeve elektronike në pikat e karburantit në Republikën e Shqipërisë. Dhe nëse përgjigja është pozitive, cili është ky institucion apo kompani private.

Në përgjigje të kërkesës së Komisionit të Prokurimit Publik, në datën 13.04.2022 është protokolluar në KPP me nr. 247/15 prot., shkresa e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial nr. 3214/1 prot., datë 11.04.2022 me objekt: “Kthim-përgjigje”, me anë të së cilës ky institucion informon, se nuk ka dijeni për institucione shtetërore apo kompani private të ngarkuara ligjërisht për certifikimin/kalibrimin etj. e sistemeve elektronike në pikat e karburantit në Republikën e Shqipërisë.

II.15. Me shkresën nr. 301/4 prot., datë 12.04.2022 me objekt: “Kthim-përgjigje”, protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 247/16 prot., datë 15.04.2022, autoriteti kontraktor informon Komisionin e Prokurimit Publik si vijon: “Në përgjigje të shkresës suaj me nr. 247/13 prot., datë 05.04.202 dhe protokolluar nga ana jonë me nr. 301/3 prot., datë 11.04.2022, ju kërkojmë ndjesë, por njësia e prokurimit nuk ishte në dijeni për paraqitjen e ankesës në mënyrë shkresore nga operatori ekonomik “Kleidi” SHPK. Materiali i pretenduar nga ankimuesi është dorëzuar edhe në Bashki në datën 15.02.2022.”

II.16. Nga verifikimet e kryera, rezulton, se nuk janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, argumente nga subjekte të interesuara, lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Kleidi” SHPK, sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Kleidi” SHPK se: “Nga verifikimi në vend nga komisioni në dt.02.02.2022 ne orën 12.13 në karburantin e shoqërisë “KLEIDI” në Vrisera, u verifikua se në karburant nuk ka sistem elektronik për kryerjen e shërbimit me karta elektronike”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.5 të dokumenteve të tenderit, rezulton se është kërkuar si vijon:

2.3.5 Pika e karburantit të jete e pajisur me autorizim për tregtim karburanti i leshuar nga njesia vendore ku ushtron aktivitetin. (Autorizim duhet të jete në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës në tender)

1. Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin me karburant në çdo ditë me shërbim 24 ore, sipas nevojave të qe ka Autoriteti Kontraktor.
2. Operatori/et Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku duhet të kryejnë furnizimin e sasisë së karburantit nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar për çdo automjet të Autoriteteteve Kontraktore. Sasia e karburantit për mjetet e renda Grejder dhe JCB do të behet me tollona.
3. Subjekti duhet të Deklarojë se e zoteron dhe e mundeson pajisjen e Autoriteti Kontraktor me Sistemin Elektronik të Vetemenaxhimit të karburantit.
 - Bazuar në VKM Nr. 561 datë 29.07.2016 “Per Standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesite e qeverisjes së pergjithshme“. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike të personalizuar me të dhenat e mjetit.

- Faqja e menaxhimit te karburanteve (webpage) duhet te ofroje sherbimin e ngarkimit te sasise se karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qellim qe rimbushja e kartave elektronike te personalizuar me te dhenat e mjetit si dhe administrimi i sasise se karburanteve te kryhet ne menyre te pavarur nga vete Autoriteti kontraktor.
- Faqja e menaxhimit te karburanteve (webpage) duhet te ofroje informacion dhe raporte te ndryshme te levrimit dhe qarkullimit te karburantit, te jete e pavarur dhe e kontrollueshme nga vet Autoriteti Kontraktor.
- Mosofrimi i sherbimeve te kerkuara me siper ne menyre elektronike nepermjet Faqes se menaxhimit te karburanteve (webpage), qe ofron cdo operator ekonomik pjesemarres perben kusht per skualifikim;

III.1.2. Në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike” të dokumenteve të tenderit, rezulton se është kërkuar si vijon:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Objekti: “BLERJE KARBURANTI PER NEVOJAT E BASHKISE PER VITIN 2022”

Të dhënat teknike të Gazoil D1 (Eurodizel) i referohen standardit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standardit shqiptar : Gazoil (Diesel) sipas Standardit SSHEN 590:2013, SSHEN 590:2017 ose certifikata ekuivalente me to.

Kërkesat e përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e provave (Gazoil)

Treguesi cilësor	Njësia e matjes	Normat e lejuara		Metoda e provës a (Shihni pikën 2. Standardet Referuese)
		minimale	maksimale	
Numri i cetanit b		51,0	-	EN ISO 5165 EN ISO 15195 EN 16144
Indeksi i cetanit		46,0	-	EN ISO 4264
Densiteti në 15 °C ^c	kg/m ³	820,0	845,0	EN ISO 3675 EN ISO 12185
Hidrokarburët aromatikë policiklikë ^d	%(m/m)	-	8,0	EN 12916
Përmbajtja e squfurit e	mg/kg	-	10,0	EN ISO 20846 EN ISO 20884 EN ISO 13032
Përmbajtja e manganezit c Nga 31. 12. 2013 Deri më 01. 01. 2014	Mg/l	- -	6,0 2,0	prEN 165765
Pika e flakërimit	°C	Mbi 55	-	EN ISO 2719
Mbetja e karbonit f (në 10 % mbetje distilimi)	%(m/m)	-	0,30	EN ISO 10370

<i>Përmbajtja e hirit</i>	% (m/m)	-	0,010	EN ISO 6245
<i>Përmbajtja e ujit</i>	mg/kg	-	200	EN ISO 12937
<i>Ndotja e përgjithshme</i>	mg/kg	-	24	EN 12662 g
<i>Korrozioni i shufrës së bakrit (3 orë në 50 °C)</i>	klasifikimi	kategoria 1		EN ISO 2160
<i>Përmbajtja e esterit të metilit të acidit yndyror (FAME)</i>	% (V/V)		7,0	EN 14078
<i>Qëndrueshmëria ndaj oksidimit</i>	g/m ³ orë	- 20	25	EN ISO 12205 EN ISO 15751i
<i>Vetitë lubrifikuese, diametri i korrektuar i njollës së gripuar (gërryer) (ësd 1,4) në 60°C</i>	µm	-	460	EN ISO 12156-1
<i>Viskoziteti në 40 °C</i>	mm ² /s	2,000	4,500	EN ISO 3104
<i>Distilimi k, l</i>				EN ISO 3405 EN ISO 3924
<i>distilati që vlon në 250°C,% (v/v)</i>	% (V/V)		<65	
<i>distilati që vlon në 350 °C,%(v/v)</i>	% (V/V)	85		
<i>distilati që vlon në 95 % (v/v)</i>	°C		360	
SHËNIM Kërkesat me shkronja të zeza i referohen Direktivës Europiane për Lëndët Djegëse 98/70/EC [1], duke përfshirë Amendamentin 2003/17/EC [2] dhe Amendamentin 2009/30/EC [3] DHE 2011/63EU [4]				

BENZINE PA PLUMB 10 PPM

Të dhënat teknike të benzine pa plumb 10 PPM i referohen standardit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standardit shqiptar : **Benzinë S SHEN 228:2012**

<i>Treguesi cilësor</i>	<i>Njësia e matjes</i>	<i>Normat e lejuara</i>	
		<i>minimale</i>	<i>maksimale</i>
<i>Pamja e jashtme</i>	<i>E pastër dhe e tejdukshme</i>		

<i>Numri oktanit kerkimor</i>		95,0	-
<i>Densiteti në 15 °C^c</i>	kg/m ³	720	775
<i>Përmbajtja e squfurit^f</i>	mg/kg	-	10
<i>Permbajtja e plumbit</i>	mg/l	-	5
<i>Stabiliteti ndaj oksidimit</i>	minuta	360	
<i>Përmbajtja e rreshirave faktike (te lara ne tretes)</i>	mg/100ml	-	5
<i>Korrozioni i shufrës së bakrit (3 orë në 50 °C)</i>	renditje	klasa 1	

<i>Permbajtja e tipit hidrokarbur</i>	<i>%(V/V)</i>		
<i>Olefinat</i>			<i>18</i>
<i>Aromantiket</i>			<i>35</i>
<i>Permbajtja e benzenit</i>	<i>%(V/V)</i>		<i>1</i>
<i>Permbajtja e oksigjenit</i>	<i>%(m/m)</i>		<i>2.7</i>
<i>Permbajtja e komponimeve</i>	<i>%(V/V)</i>		
<i>oksigjenore</i>			<i>3</i>
<i>methanol</i>			<i>5</i>
<i>etanol</i>			<i>10</i>
<i>alkool iso-propilik</i>			<i>10</i>
<i>alkool iso-butilik</i>			<i>7</i>
<i>alkool terc-butil</i>			<i>15</i>
<i>etere(me 5 ose me shume atome C)</i>			<i>10</i>
<i>komponime oksigjenore te tjera</i>			

- *Fatura tatimore e shitjes e lëshuar nga operatori ekonomik duhet të shoqërohet me:*
- *Strukturën e llogaritjes së çmimit për litër.*
- *Buletinin e fundit të çmimeve të APP (Agjencisë së Prokurimit Publik)*
- *Furnizimi do të kryhet nepermjet kartes elektronike pervec mjeteve te renda JCB dhe Grejderit qe do behet me tollona.*
- *Kartat elektronike do të jene te vlefshem edhe pas perfundimit te kontrates*
- *Operatori ekonomik duhet të kete të pakten një pike tregëtimi karburanti me pakice brenda territorit të Bashkise per permbushje te nevojave vazhdueshme dhe ne menyre te leverdishme per Autoritetin Kontraktor.*

Pershkrimi dhe kerkesat e Autoritetit Kontraktor:

- *Sasia e karburantit do të lëvrohet nga kontraktuesi nëpërmjet kartave elektronike per cdo mjet pervec mjeteve te renda JCB dhe Grejderit qe do behet me tollona.*

Te dhenat per mjetet do ti jepen kontraktorit ne momentin e lidhjes se kontrates.

Shperndarja e karburantit (Ngarkesa e kartave) do behet nga autoriteti kontraktor nepermjet sistemit elektronik sipas planit te miratuar nga Keshilli i Bashkise per vitin 2022.

III.1.3. Shtojca 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, Pjesa III, Pika A e dokumenteve të tenderit parashikon si vijon:

Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

<i>Deklarata</i>	<i>Përgjigje</i>
<i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër</i>	<i>Po [] Jo []</i>

<i>të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.</i>	
--	--

[...]

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë të informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

Shenim: Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.1.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik "Kleidi" SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar si më poshtë:

1. Autorizim "Për tregtimin me pakicë të karburanteve për kategoritë e produkteve Benzinë kateg. II/A, Gazoil kateg.II/A, GLN Kateg I/A", lëshuar nga Bashkia Dropull Gjirokastër, për personin juridik "Kleidi" SHPK.

2. Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku rezulton se në Pjesën III, Pika A të tij është deklaruar dhe pohuar shprehimisht: "Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.

3. Deklaratë e operatorit ekonomik "Kleidi" SHPK me përmbajtjen si vijon:

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë 01.02.2022 nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Dropull me objekt: Blerje karburanti për nevojat e bashkisë për vitin 2022; me fond limit: 7.280.718 (Shtatë milion e dyqind e tetëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë) Lek pa TVSH.

Unë i nënshkruari L. M., me cilësinë e Administratorit të operatorit ekonomik "Kleidi" sh.p.k, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

-Shoqëria "Kleidi" sh.p.k, ofron shërbimin e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor për ofromin e faqes së menaxhimit U karburanteve (webpage).

-Shoqëria "Kleidi" sh.p.k, merr persiper furnizimin me karburant ne cdo dite me sherbim 24 ore, sipas nevojave qe ka Autoriteti Kontraktor.

-Shoqëria "Kleidi" sh.p.k, do të kryejë furnizimin e sasisë së karburantit nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar për çdo automjet të Autoritetit Kontraktor. Sasia e karburantit për mjetet e rënda Grejder dhe JCB do të bëhet me tollona.

-Shoqëria "Kleidi" sh.p.k, zotëron dhe e mundëson pajisjen e Autoriteti Kontraktor me Sistemin Elektronik të Vetmenaxhimit të karburantit.

-Shoqëria “Kleidi” sh.p.k, deklaroi se bazuar në VKM Nr 561 datë 29.07.2016 “Për Standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, ofron një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit do të kryhet nëpërmjet kartës elektronike të personalizuar me të dhënat e mjetit.

-Shoqëria “Kleidi” sh.p.k, deklaroi se faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) ofron shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me të dhënat e mjetit, si dhe administrimi i sasisë së karburanteve, do të kryhet në mënyrë të pavarur nga vet Autoriteti kontraktor.

-Shoqëria “Kleidi” sh.p.k, deklaroi se faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) ofron informacion dhe raporte të ndryshme të lëvrimit dhe qarkullimit të karburantit dhe është i pavarur dhe i kontrollueshëm nga vet Autoriteti Kontraktor.

III.1.5. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

III.1.6. Neni 40 pika 3 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

3.Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.7. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik nga autoriteti kontraktor Bashkia Dropull, rezultoi se në datën 02.02.2022 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka mbajtur një procesverbal, i cili bën fjalë mbi verifikimin e sistemit të kartave elektronike për furnizimin me karburant, në karburantin e shoqërisë “Kleidi” SHPK, në Kakavijë. Sipas KVO-së, një nga kushtet e parashikuara në dokumentet e tenderit është furnizimi me karta elektronike. [...] Nga verifikimi në vend

rezultoi se karburanti në fjalë nuk ka sistem për pajisjen dhe kryerjen e shërbimit me karta elektronike.” Bashkëngjitur foto e karburantit.

Ky procesverbal rezultoi në nënshkruar dhe firmosur vetëm nga anëtarët e komisionit të verifikimit të autoritetit kontraktor Bashkia Dropull.

III.1.8. Lidhur me arsyen e shkualifikimit, në ankesën e paraqitur në KPP dhe në autoritetin kontraktor, operatori ekonomik ankimes pretendon se: “Bazuar në parimet e përgjithshme në nenin 3 të Prokurimit Publik në të cilin citohet se: “Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprimet me transparencë e në mënyrë proporcionale” vlerësimi i bërë nga autoriteti është i njëanshem pasi në deklaratën të cilën ne kemi dërguar pranë sistemit të Autoritetit Kontraktor citohet se: “Shoqëria “KLEIDI SH.P.K” do të kryejë furnizimin e sasisë të karburantit nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar për çdo automjet të Autoritetit Kontraktor. Sasia e karburantit për mjetet e renda Grejder dhe JCB do të bëhet me tollona. - ‘Shoqëria “KLEIDI SH.P.K” zoteron dhe mundeson pajisjen e Autoritetit Kontraktor me sistemin elektronik të vetmenaxhimit të karburantit.’

Komisioni i dërguar në dt. 02.02.2022 pranë pikës tonë të tregtimit të karburantit në Vrisherë nuk disponon asnjë provë konkrete për të hedhur poshtë deklaratat tona të siperpërmendura. Neni 26 pika 7 të vkm nr.285 dt.19.05.2021 thotë: “Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, dhe t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ne nuk na është bërë asnjë kërkesë për sqarim dhe nuk kemi informacion se ku dhe kur është bërë ky verifikim. Kompania jonë nuk ka asnjë dijeni për kontrollin e bërë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i cili ka dalë në këtë përfundim pasi nuk është bërë lajmërimi në asnjë nga format e caktuara sipas ligjit sepse në dokumentet tanë janë vendosur numrat e kontaktit si edhe email për të komunikuar me personat përgjegjës dhe për të bërë verifikimin eficient. Ne zotërojmë 5 (pesë) pika karburantesh dhe të gjitha janë të pajisura me sistemin e kartave elektronike të personalizuar. Gjithashtu zotërojmë kontrata të ngjashme me disa institucione si: Bashkia Memaliaj, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë , Këshilli I Qarkut Tiranë, Bashkia Libohovë në të cilat funksionojnë në mënyrën elektronike të furnizimit me karburant. Ne vazhdojmë të qendrojmë deklaratën se dhënë në të cilën garantojmë shërbimin ashtu sic na është kërkuar nga Autoriteti. Ju lutemi të kontaktoni me ne një nga menyrat e komunikimit të shoqërisë tonë për të bërë demonstrim praktik sesi vërtet funksionon sistemi dhe për ta bërë defakto atë cka kemi garantuar në deklaratën e dorëzuar.

Referuar arsyes të shkualifikimit sipas së ciles KVO pretendon se është paraqitur në pikën e karburantit dhe pretendon se karburanti nuk ka sistem elektronik për kryerjen e shërbimit me karta elektronike, është një arsye totalisht objektive dhe e pambeshtetur në format e komunikimit zyrtar ligjor mes autoritetit që zhvillon procedurën dhe operatorin ekonomik. Sipas parimeve të ligjit nr. 162/2020 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, parashikohet se palët në një procedurë prokurimi komunikojnë me shkrim ose mënyrë elektronike. Në rastin konkret përpara fillimit të një procedure verifikimi, autoriteti ka detyrimin të njoftojë me shkrim, e mail ose përmes sistemit SPE, operatorin ekonomik për datën dhe orën e paraqitjes, arsyes së prezencës dhe verifikimit si dhe emrat e personave që do të paraqiten.

Ditën dhe orën e caktuar personat që paraqiten duhet të jenë të pajisur me një autorizim nga titullari i autoritetit kontraktor si dhe të disponojnë dokumentet personal të identifikimit. Në rastin konkret nuk është ndjekur fare kjo procedurë. KVO pretendon se ka qenë pranë subjektit në datën 02.02.2022 por pa paraqitur asnjë autorizim asnjë kartë identiteti. Pra thjesht është paraqitur, pretendon se nuk ka gjetur sistem dhe ka ikur. Pra as ka kërkuar sqarime apo dokumentacion administratorit të subjektit. Dhe duke dalë në një konkluzion totalisht të pavërtetë dhe hipotetik. Pika 6 e nenit 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Rr.P.P” percakton se: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Pika 7 e nenit 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Rr.P.P” percakton se: Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ne rastin konkret, sikurse e parashikojnë dhe dispozitat e nenit 26 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “RrPP”, percaktohet se AK vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të për ankime i kërkon operatorit ekonomik të klasifikuar i pari dokumentet provuese të dorëzuara në sistem, përfshire dokumente dhe deklarime. Nga interpretimi literal i dispozitës së parashikuar në piken 6 të nenit 26, nënkuptohet se AK ka detyrimin që të përfundojë me njoftimin e klasifikimit dhe më pas ka të drejtë të kryejë verifikimi në çdo rast (NE CDO RAST, JO NE CDO KOHË).

Në rastin konkret AK jo që nuk ka zbatuar procedurën e parashikuar më sipër por nuk ka respektuar asnjë praktike ligjore që të provojë ligjshmërinë e veprimeve të tij të dokumentuara. Nisur nga sa argumentuam me sipër ne kerkojmë shfuqizimin e vendimit të KVO për klasifikimin perfundimtar të ofertave dhe rivleresimin e ofertave duke vendosur kualifikimin e ofertës së paraqitur nga ana jonë dhe shpalljen e saj fituese.

III.1.9. Në përgjigje të ankesës së ankimuesit, në datën 11.02.2022 autoriteti kontraktor i ka dërguar një kërkesë ankimuesit, nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve, ku i kërkon si më poshtë vijon:

“Komisioni i Shqyrtimit të ankesës ju kërkon të vini në dispozicion shitjet me kartë elektronike që keni kryer nga pika e karburantit me adresë Dropull e Sipërm, Vrisera, Rruga Nacionale Gjirokastër-Kakavijë, deri në datën 02.02.2022.

Nga Komisioni i Shqyrtimit të ankesës.”

Sipas autoritetit kontraktor, kërkesës së bërë nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, ankimuesi i është përgjigjur nëpërmjet adresës së tij elektronike (email) si vijon: “Ndjesë që po ju shkruaj kaq shume por...mendoj se jeni jashtë kompetencave tuaja.”

Pavarësisht se me anë të shkresës së protokolluar në KPP me nr.247/4 protokoli, datë 23.02.2022, operatori ekonomik Kleidi SHPK ka vënë në dispozicion të Komisionit edhe një adresë webi me të dhënat e përdoruesit “KPP” dhe me fjalëkalim të personalizuar, nga

verifikimi i kryer online, në asnjë moment nuk vërtetohet data e instalimit të faqes. Për më tepër ankimesi nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit të Prokurimit Publik asnjë dokument justifikues për momentin e instalimit të këtij sistemi elektronik, siç parashikohet në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, i ndryshuar, se: *“Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*. Pra KPP, nuk ka mundësi të vërtetojë faktin, nëse ky sistem është instaluar para apo pas datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit.

III.1.10. Referuar sa më lart, KPP vëren, se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi ka kërkuar furnizimin e sasisë së karburantit nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar. Kjo kërkesë duhej plotësuar nga ofertuesit nëpërmjet një deklaratë, kërkesë e cila rezulton se është plotësuar nga ana e ankimesit, i cili ka paraqitur deklaratë, sipas të cilës merr përsipër të kryejë furnizimin e sasisë së karburantit nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar për çdo automjet të Autoritetit Kontraktor. Njëkohësisht në dokumentet e tenderit është parashikuar, që autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë të informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik (për sa më sipër), ndaj dhe për këtë arsye, KVO-ja ka ushtruar të drejtën e saj për verifikim në pikën e karburatit Kakavijë, në administrim nga shoqëria “Kleidi” SHPK. Në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim konstatohet, se mungon nënshkrimi nga përfaqësues të operatorit ekonomik ankimes, pra në këtë kuptim ky procesverbal është i njëanshëm. Për më tepër, që autoriteti kontraktor nuk ka paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik asnjë dokument që të vërtetojë njoftimin e bërë ankimesit lidhur me këtë verifikim. Për këtë parregullsi të konstatuar mban përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i cili nuk ka qenë transparent në verifikimin e kryer, në kundërshtim me nenin 3 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” sipas të cilit: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar”* si dhe nenin 82 të rregullave të prokurimit publik ku thuhet se: *“Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë”*.

Megjithatë rezulton, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, në përgjigje të pretendimeve të ankimesit, në datën 11.02.2022, i ka kërkuar nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve këtij të fundit, të vërë në dispozicion (të këtij komisioni), shitjet me kartë elektronike që janë kryer nga pika e karburantit me adresë Dropull e Sipërm, Vrisera, Rruga Nacionale Gjirokastër-Kakavijë, deri në datën 02.02.2022. Nga përgjigja e shoqërisë “Kleidi” SHPK dhënë këtij komisioni: *“Ndjesë që po ju shkruaj kaq shume por...mendoj se jeni jashtë kompetencave tuaja”*, rezulton, se ankimesi nuk i është përgjigjur kërkesës për sqarim të

KSHA-së në kundërshtim me pikën 7 të nenit Neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të VKM - së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit: “Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime” dhe nenin 82 të LPP-së sipas të cilit: “Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.”

Komisioni gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor, që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se operatori ekonomik “Kleidi” SHPK, nuk ka arritur të vërtetojë se karburanti i administruar prej tij pika e karburantit me adresë: *Dropull i Sipërm, Vrisera, Rruga Nacionale Gjirokastër-Kakavijë*, përmbush kërkesën e autoritetit kontraktor për kryerjen e furnizimit me karburant nëpërmjet kartave elektronike.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Kleidi” SHPK qëndrojnë pjesërisht.

III.2. Referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, rezulton, se autoriteti kontraktor ka dhënë informacion kontradiktor lidhur me dorëzimin e ankesës së shoqërisë “Kleidi” SHPK në Bashkinë Dropull.

Konkretisht me shkresën nr. 301/2 prot., datë 30.03.2022 me objekt: “*Kthim-përgjigje*”, dërguar nëpërmjet postës elektronike zyrtare të KPP-së, autoriteti kontraktor informon Komisionin e Prokurimit Publik se: “*Në përgjigje të shkresës tuaj me nr. 247/9 prot., datë 30.03.2022, bazuar në vendimin nr.1/2022 të autoritetit kontraktor, me nr.301 prot., datë*

15.02.2022 e kemi theksuar te rrethanat e çështjes, pika II.6 “Në datën 09.02.2022 operatori ekonomik “Kleidi” SHPK ka paraqitur ankesë nëpërmjet sistemit të APP-së dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik me objekt kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit të tij në procedurën e prokurimit të objekt-ankimit.” Ndërsa pranë bashkisë tonë nuk është dorëzuar formulari i ankesës së operatorit ekonomik “Kleidi” SHPK në rrugë shkresore.” Ndërsa me shkresën nr. 301/4 prot., datë 12.04.2022 me objekt: “Kthim-përgjigje”, protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 247/16 prot., datë 15.04.2022, autoriteti kontraktor informon Komisionin e Prokurimit Publik se: “Në përgjigje të shkresës suaj me nr. 247/13 prot., datë 05.04.202 dhe protokolluar nga ana jonë me nr. 301/3 prot., datë 11.04.2022, ju kërkojmë ndjesë por njësia e prokurimit nuk ishte në dijeni për paraqitjen e ankesës në mënyrë shkresore nga operatori ekonomik “Kleidi” SHPK. Materiali i pretenduar nga ankimesi është dorëzuar edhe në Bashki në datën 15.02.2022.”

Nga shqyrtimi i të gjithë dokumentacionit të depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik rezulton, se operatori ekonomik ankimes ka respektuar afatet procedurale të vendosura nga ligji, për paraqitjen e ankesës në autoritetin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë. 7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. 8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

Pra Autoriteti Kontraktor në tërësi ka shfaqur konfuzion mbi depozitimin e ankesës së operatorit ekonomik “Kleidi” SHPK dhe me veprimet dhe mosveprimet e tij ka shkaktuar tejzgjatje të procedurës.

Në nenin 131 pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se : “1. Refuzimi i autoritetit ose entit kontraktor për të bashkëpunuar me Komisionin e Prokurimit Publik dhe Agjencinë e Prokurimit Publik ngarkon me përgjegjësi titullarin e autoritetit kontraktor dhe dënohet nga këto institucione me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë. 2. Masa e gjobës vendoset në raport me vlerën e përlllogaritur të kontratës dhe sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik”.

Në këtë kuptim, referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se me anë të mosveprimit, autoriteti kontraktor ka refuzuar të bashkëpunojë me Komisionin e Prokurimit Publik, duke mos dërguar informacionin e saktë edhe pas insistimit të këtij të fundit, në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik ankimes “Kleidi ” SHPK, në kuptim të nenit 110 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Në informacionin e depozituar nga autoriteti kontraktor pranë KPP-së me nr. 301/4 prot., datë 12.04.2022 me objekt: “*Kthim-përgjigje*”, protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 247/16 prot., datë 15.04.2022, autoriteti kontraktor informon Komisionin e Prokurimit Publik se: “*Në përgjigje të shkresës suaj me nr. 247/13 prot., datë 05.04.202 dhe protokolluar nga ana jonë me nr. 301/3 prot., datë 11.04.2022, ju kërkohet ndjesë, por njësia e prokurimit nuk ishte në dijeni për paraqitjen e ankesës në mënyrë shkresore nga operatori ekonomik “Kleidi” SHPK. Materiali i pretenduar nga ankimesi është dorëzuar edhe në Bashki në datën 15.02.2022.*” Bashkëngjitur shkresës së mësipërme, autoriteti kontraktor nuk ka vendosur në dispozicion të KPP-së asnjë dokument që të vërtetojë pohimin e bërë.

KPP gjykon, se mosbashkëpunimi në kuptim të nenit 131 të ligjit nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*”, përfshin si rastin klasik të mosdërgimit të informacionit të kërkuar nga Komisioni i Prokurimit Publik, por gjithashtu mosbashkëpunimi është edhe më i rëndë në rastin kur autoriteti kontraktor dërgon një informacion jo të saktë pranë KPP-së.

Sa më sipër, në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës së procedurës së prokurimit, si edhe duke marrë në konsideratë faktin se zyrtari përgjegjës nuk është përsëritës në shkeljen administrative, në mbështetje të nenit 24 nenit 131 të Ligjit Nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, Ligjit Nr. 10279 datë 20.5.2010 “*Për kundërvajtjet administrative*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”* Komisioni i Prokurimit Publik, vendos të marrë masën administrative gjobë në masën 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë për Z. Dhimitraq Toli, Titullar i Autoritetit Kontraktor Bashkia Dropull, për mosbashkëpunim me Komisionin e Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “*E hapur, e thjeshtuar*” me Nr. REF-17375-01-19-2022, me objekt “*Blerje karburanti për nevojat e Bashkisë për vitin 2022*” me fond limit 7,280,718.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 01.02.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dropull.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Ligjit Nr. 10279 datë 20.5.2010 “*Për kundërvajtjet administrative*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “*Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Kleidi” SHPK për procedurën e prokurimit “*E hapur, e thjeshtuar*” me Nr. REF-17375-01-19-2022, me objekt “*Blerje karburanti për nevojat e Bashkisë për vitin 2022*” me fond limit 7,280,718.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 01.02.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dropull.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Të marrë masën administrative gjobë në masën 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë për Z. Dhimitraq Toli, Titullar i Autoritetit Kontraktor Bashkia Dropull, për mosbashkëpunim me Komisionin e Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “*E hapur, e thjeshtuar*” me Nr. REF-17375-01-19-2022, me objekt “*Blerje karburanti për nevojat e Bashkisë për vitin 2022*” me fond limit 7,280,718.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 01.02.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dropull.
 4. Kjo gjobë përbën titull ekzekutiv.
 5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kundër vendimit për marrjen e masës administrative (gjobë) mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, në përputhje me Ligjin nr. 10279 datë 20.5.2009 “Për kundërvajtjet administrative”.
 7. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Kleidi” SHPK.
 8. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Monitorimit Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror.
 9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

MENDIM KUNDËR

Mendim kundër i Kryetarit të Komisionit të Prokurimit Publik z. Jonaid Myzyri në lidhje me vendimin e shumicës.

Si Kryetar i Komisionit të Prokurimit Publik, shpreh pjesërisht mendimin kundër vetëm për sa i përket arsytimit të vendimit mbi themelin e çështjes dhe rrjedhimisht dhe të dispozitivit të tij, për sa i përket ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Kleidi” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-17375-01-19-2022, me objekt “Blerje karburanti për nevojat e Bashkisë për vitin 2022” me fond limit 7,280,718.00 lekë pa TVSH.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyetoj:

I.1 Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues se: *“Ne mbeshetjetje te nenit 26 pika 7 te vkm nr.285 dt.19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik: Autoriteti kontraktor ka te drejte te kryeje verifikimet e nevojshme mbi vertetesine e informacionit te deklaruar nga operatori ekonomik...Nga verifikimi ne vend nga komisioni ne dt.02.02.2022 ne oren 12.13 ne karburantin e shoqerise “KLEIDI” ne Vrisedra, u verifikua se ne karburant nuk ka sistem elektronik per kryerjen e sherbimit me karta elektronike.”* gjykoj se:

I.2. Në shtojcën 8 *“Kriteret e Veçanta për Kualifikim”*, pika 2.2.4 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, është parashikuar plotësimi i kërkesës si më poshtë vijon:

Në shtojcën 7 *“Kriteret e veçanta të kualifikimit”*, *“Kapaciteti teknik”*, pika 2.3.5 të dokumenteve të tenderit, rezulton se është kërkuar si vijon:

2.3.5 Pika e karburantit te jete e pajisur me autorizim per tregtim karburanti i leshuar nga njesia vendore ku ushtron aktivitetin. (Autorizim duhet te jete ne emer te operatorit ekonomik pjesemarres ne tender)

- 1. Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin me karburant në çdo ditë me shërbim 24 orë, sipas nevojave që ka Autoriteti Kontraktor.*
- 2. Operatori/et Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku duhet të kryejnë furnizimin e sasisë se karburantit nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar për çdo automjet të Autoriteteve Kontraktore. Sasia e karburantit për mjetet e rënda Grejder dhe JCB do të bëhet me tollona.*

3. Subjekti duhet te Deklaroje se e zoteron dhe e mundeson pajisjen e Autoriteti Kontraktor me Sistemin Elektronik te Vetemenaxhimit te karburantit.

- Bazuar ne VKM Nr. 561 date 29.07.2016 “Per Standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshme“. Operatoret ekonomik pjesemarres duhet te ofrojne nje faqe menaxhimi te karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit te kryhet nepemjet kartes elektronike te personalizuar me te dhenat e mjetit.
- Faqja e menaxhimit te karburanteve (webpage) duhet te ofroje sherbimin e ngarkimit te sasise se karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qellim qe rimbushja e kartave elektronike te jete e personalizuar me te dhenat e mjetit si dhe administrimi i sasise se karburanteve te kryhet ne menyre te pavarur nga vete Autoriteti kontraktor.
- Faqja e menaxhimit te karburanteve (webpage) duhet te ofroje informacion dhe raporte te ndryshme te levrimit dhe qarkullimit te karburantit, te jete e pavarur dhe e kontrollueshme nga vete Autoriteti Kontraktor.
- Mosofrimi i sherbimeve te kerkuara me sipër ne menyre elektronike nepermjet Faqes se menaxhimit te karburanteve (webpage), qe ofron cdo operator ekonomik pjesemarres perben kusht per skualifikim

I.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, vlerësoj se në përmbushje të kriterit të mësipërm, ashtu sikundër është pasqyruar edhe në mendimin e shumicës, ankimesi ka dorëzuar tri akte : Autorizim “Për tregtimin me pakicë të karburanteve për kategoritë e produkteve Benzinë kateg. II/A, Gazoil kateg.II/A, GLN Kateg I/A”, lëshuar nga Bashkia Dropull Gjirokastrë, për personin juridik “Kleidi” SHPK, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit në të cilën deklaroi se përmbush të gjitha specifikimet teknike siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, si edhe një deklaratë të posaçme me anë të së cilës, shoqëria ka marrë përsipër ofrimin e faqes së menaxhimit të karburanteve, furnizimin me karburant me anë të sistemit të kartave elektronike, sistemit elektronik të vetëmenaxhimit të karburantit.

Njëkohësisht, në dokumentet e tenderit është parashikuar, që autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë të informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik (për sa më sipër), ndaj dhe për këtë arsye KVO-ja ka ushtruar të drejtën e saj për verifikim pranë shoqërisë “Kleidi” SHPK. E drejta e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është e mbështetur në nenin 82 pika 1 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku parashikohet se : “Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve.”

Referuar dokumentacionit të administruar, nuk rezulton që nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të jetë marrë vendim për kryerjen e verifikimeve, datën e kryerjes ose pezullimin e procesit të shqyrtimit.

Duke vlerësuar se në rregullat e prokurimit publik nuk parashikohet një procedurë e detajuar e kryerjes së verifikimeve nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, vlerësoj se duhet t'i referohemi parashikimeve të Kodit të Procedurave të Administrative.

E drejta e autoritetit kontraktor, me qëllim për përcaktimin e gjendjes, fakteve dhe rrethanave për zgjidhjen e themelit të çështjes, rregullohet edhe nga Kodi i Procedurave Administrative. Është e drejtë e autoritetit kontraktor të kërkojë marrjen e provave në kuptim të nenit 80 pika 1 gërma "c" të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", (këtu e në vijim K.Pr.A) të kryejë verifikime, për t'u garantuar për përmbushjen e specifikimeve teknike sipas deklaratave të bëra nga vetë ofertuesi.

Në nenin 84 të Kodit të Procedurave Administrative, parashikohet se: "**Në rastet kur palët janë të detyruara të paraqesin informacion ose prova, pala duhet të njoftohet me shkrim apo në mënyrë verbale, sipas afateve dhe parashikimeve të këtij Kodi.**" Referuar dokumentacionit të administruar pjesë e fashikullit të shqyrtimit administrative, nuk verifikohet se nga ana e autoritetit kontraktor janë mbajtur në konsideratë parashikimet e K.PrA për njoftimin e palëve, në përputhje me një nga mënyrat e parashikuara në Kod. Referuar veprimeve procedurale paraprake të kryera nga autoriteti kontraktor, nuk provohet se operatori ekonomik ankimues ka marrë njoftim në përputhje me sa më sipër sqaruar mbi kryerjen e verifikimeve nga ana e autoritetit kontraktor.

Gjithashtu, rezulton e provuar, se në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim, mungon nënshkrimi nga përfaqësues të operatorit ekonomik ankimues. Vlerësoj, se me dokumentacionin e dorëzuar, nuk arrihet të provohet se përfaqësues të operatorit ekonomik kanë qenë prezent në momentin e kryerjes së verifikimit, duke e kthyer këtë procedurë në të njëanshme.

Sa më sipër, duke qenë se procedura e ndjekur nga autoriteti kontraktor nuk është e plotë, nuk ka përmbushur garancitë procedurale për palët, të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative, si edhe nuk provohet se pala ka qenë prezente në momentin e kryerjes së verifikimit, nuk mund të vlerësohet, se në momentin e dorëzimit të ofertave dhe në momentin e kryerjes së verifikimit nga ana e autoritetit kontraktor ankimuesi, nuk përmbushet kriteri i kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor.

Referuar dokumentacionit të administruar rezulton, se autoriteti kontraktor si provë, krahas dokumentacionit, ka dorëzuar edhe një foto të pretenduar të pikës së ofrimit të shërbimit (karburantit) të operatorit ekonomik "Kleidi" ShPK.

- Së pari, referuar formës së provës të dorëzuar nuk përmbushen elementet formale të parashikuara nga neni 49 pika 2 dhe 7 të K.Pr.A.

- Së dyti, mendoj se me anë të fotografisë së dorëzuar, nuk vërtetohet nëse pika e ofrimit të shërbimit është e operatorit ekonomik ankimues, si edhe nëse ajo e disponon ose jo shërbimin e kërkuar.

Gjithashtu, në rast se do të referohemi kriterit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit rezulton, se kërkesa e vetme e autoritetit kontraktor, që lidhet me pikën e karburantit, është ajo e përcaktuar në pikën 2.3.5 të dokumenteve të procedurës së prokurimit, pra, që pika e karburantit të jetë e pajisur me autorizim për tregtim karburanti lëshuar nga NjQV ku ushtron aktivitetin, ndërkohë që kriteret e tjera (përfshirë edhe atë të menaxhimit të karburantit me anë të kartave elektronike të personalizuar) lidhen me operatorin ekonomik (personalitetin juridik) dhe jo me pikën e ofrimit të shërbimit individuale.

Referuar dokumentacionit nuk konstatohet, se autoriteti kontraktor pas verifikimit të kryer, të ketë konstatuar deklaram të rremë për qëllime kualifikimi nga ana e ankimuesit, në përputhje me nenin 76 pika 3 gërma “ë” të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se: *“Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklaratat të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;”*

Gjithashtu, nuk rezulton sipas akteve të dosjes, që autoriteti kontraktor të ketë njoftuar Agjencinë e Prokurimit Publik, për paraqitjen e deklaratave të rrema, për qëllime kualifikimi në përputhje me pikën 5 të nenit të sipërcituar.

Me anë të shkresës nr.247/4 protokolli, datë 23.02.2022, operatori ekonomik Kleidi ShPK, ka vënë në dispozicion të Komisionit edhe një adresë uebi me të dhënat e përdoruesit ‘KPP’ dhe me fjalëkalim të personalizuar. Nga verifikimi, rezulton, se kjo faqe është aktive. Ndërkohë, nuk provohet, nëse ka qenë aktive në datën e dorëzimit të ofertave dhe të kryerjes së verifikimit nga ana e autoritetit kontraktor.

Referuar hetimit të kryer, rezulton, se me shkresën nr.3214/1 protokolli, datë 11.04.2022, të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial, deklarohej se *“ISHTI nuk ka dijeni për institucione shtetërore apo kompani private të ngarkuara ligjërisht për certifikimin/kalibrimin/etj. të sistemeve elektronike në pikat e karburantit në Republikën e Shqipërisë”*.

Kështu vlerësoj, se ndodhemi në kushtet, kur nuk mundet të merret konfirmim nga një palë e tretë jashtë procesit të shqyrtimit administrativ, që mund të vërtetojë faktin nëse operatori ekonomik dispononte ose jo (në datën e zhvillimit të procedurës) mundësinë e kryerjes së shërbimit të kërkuar, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë

të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Sa më sipër, mendoj se nuk mund të shprehem mbi themelin e ankesës, duke qenë se është plotësisht e pamundur të kryhet një vlerësim i drejtë i përmbushjes ose jo të kriterit nga ana e autoritetit kontraktor. Akoma më tej, kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor nuk ka natyrën e një kriteri të posaçëm kualifikimi, por më shumë në aspektin formal dhe procedural është një përshkrim i mënyrës së ofrimit të shërbimit, që i takon termave të referencës së shërbimit dhe jo kriterëve kualifikuese.

Në respekt të nenit 77 të ligjit për prokurimin publik autoritetet përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në tre elementë: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Pika 5 e nenit 77 parashikon ndër të tjera, se autoritetet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si **dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve**. Në rastin konkret, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si dokument vetëm aktin individual të vetëdeklarimit dhe asnjë dokument tjetër konkret provues, që do të jepte mundësinë për zgjidhjen e konfliktit administrativ mes palëve.

Në kushtet kur referuar edhe informacionit të dorëzuar nga ISHTI, në cilësinë e organit të specializuar për kontrollin e veprimtarisë të personave juridikë në fushën e hidrokarbureve, si edhe që ushtron kontrole në këto subjekte, nuk ka institucione publike apo private të ngarkuara nga ligji për certifikimin/kalibrimin e sistemeve elektronike, vlerësoj se kriteri i mësipërm i kualifikimit nuk është hartuar në respekt të parimeve të mësipërme ligjore. Theksoj qëndrimin, se kriteret e kualifikimit nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt-prokurimi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit në këtë procedurë.

Parë në këtë drejtim, bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin

dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”, mendoj se kjo procedurë prokurimi duhet të anulohet për shkak të shkeljeve procedurale dhe mënyrës së hartimit të kriterit, si edhe në rishpalljen e saj, të rishikohej ky kriter.

Kryetar

Jonaid Myzyri